



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## **RrGGK Reagon lidhur me Dyshimet për Heqje të Mitrave e Abuzime Seksuale me Pacientë në Institutin Special në Shtime**

*Prishtinë, 27 Mars 2014*

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) reagon lidhur me dyshimet se pacientët në Institutin Special në Shtime abuzohen seksualisht nga personeli, rrihen dhe keqtrajtohen, duke dënuar këto veprime jo njerëzore, në rast se vërtohen që janë të vërteta.

Bazuar në shkrimin e publikuar në mediat online dhe të shkruara (<http://www.kohaditore.com/?id=27&l=4297> dhe Koha Ditore, datë: 27 Mars 2014 ) ku ipen detaje më të hollësishme dhe citohen burime informatash, RrGGK bën thirrje tek organet kompetente që të hetojnë këto dyshime dhe të ndërmarrin masat e duhura për ndalimin e këtyre veprimeve.

Poashtu, RrGGK kërkon nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të ndërmarrë masat e duhura për të parandaluar që akte të tilla të ndodhin brenda Institutit Special në Shtime.